



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:223122
Datë: 02.09.2024
Numri i dokumentit: 06112219

PPP.nr.1058/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti I Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren inividuale Erolinda Uka-sadiku, në çështjen juridike të kreditorit K.K. për F. me E. E. me seli në P., kundër debitorit A.D.,nga fshati K., Komuna e M., lidhur me çështjen përmbartimore për përmbushjen e borxhit në shumë prej 1,416.99 euro, e kthyer në rigjykim me aktvndimin AC.nr.903/21 të datës 07.07.2021m duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.1703/19 të datës 18.04.2019, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, pas përfundimit të seancës publike, me datën të njejtën ditë mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit A.D., nga fshati K. K. e M., ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.1703/19 i datës 18.04.19, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa në Mitrovicë, për periudhën kohore nga data 04.06.2013 deri me datën 10.12.2017 në shumë prej 1,020.53 euro.

II.REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit A.D., nga fshati K. K. e M.,sa i përket pjesës së borxhit për periudhën kohore nga data 09.01.2018 e deri me datën 09.03.2019 në shumën prej 396.46, sa i përket kësaj pjese të Urdhrit Përmbartimor P.nr.1703/19 i datës 18.0419, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, në Mitrovicë, mbetet në fuqi.

III. Në rast se pala debitore parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, OBLIGOHET që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 396.46 euro.

IV. Në rast se pala debitore dështon të paguajë shumën e lartcekur të garancionit brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

A r s y e t i m

Kreditori, K.K.F. me E.E. me seli në Prishtinë, me datën, përmes përmbauesit privat Atip Mustafa, ka paraqitur urdhërin përmbaues P.nr.1703/19 të datës 18.04.2019, me të cilin ka kërkuar lejimin e përmbauesit në shumë prej 1,416.99 euro për shkak të shpenzimeve të energjisë elektrike.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin PPP.nr.610/19 të datës 16.07.2019 ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit ashtu që ka shfrytëzuar pjesërisht Urdhërin për Lejimin e Përmbauesit Pnr.781/19 të datës 18.04.2019, dhe ka obliguar debitorin Ahmet Dorici që në emër të shfrytëzimit për energjinë e konsumuar të paguajë shumën prej 342.78 euro për periudhën kohore 01.01.2018 deri me datën 09.03.2019.

Kreditore ndaj aktvendimit të lartëcekur ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbaues, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jotë plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e Apelit me aktvendimin AC.nr.4426/19 të datës 22.05.2020 aprovoi sitë bazuar ankesën e kreditorit, prishi aktvendimin e gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.610/19 të datës 16.07.2019 dhe lëndën e ktheu në riprocedurë dhe vendosje.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, për lëndën e kthyer në rigjykim me Aktvendimin PPP.nr.262/20 të datës 07.10.2020 aprovoi pjesërisht prapësimin e debitorit ashtu që shfrytëzoi Urdhërin për Lejimin e Përmbauesit Pnr.781/19 të datës 18.04.2019, për periudhën kohore nga data 04.06.2013 deri më 31.12.2017 në shumë prej 1.074.21 euro dhe ka obliguar debitorin Ahmet Dorici që në emër të shfrytëzimit për energjinë e konsumuar të paguajë shumën prej 342.78 euro për periudhën kohore 01.01.2018 deri me datën 09.03.2019.

Kreditore Brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbaues, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jotë plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e Apelit, me Aktvendimin AC.nr.903/21 të datës 07.07.2021 ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit dhe ka prishur aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.262/20 të datës 07.10.2020 dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje.

Gjykata e Apelit me Aktvendimin AC.nr.903/21 të datës 07.07.2021 ka udhëzuar gjykatën e shkallës së parë të caktojë seancë dëgjimore, në mënyrë që të përcaktojë qartë çështjen e parashkrimit të kërkesave të parashkruara dhe kërkesave të cilat nuk kanë arritur parashkrimin.

Në seancë, përfaqësuesi i kreditorit ka deklaruar se mbetemi në tërësi pranë përgjigjes së dhënë në prapësim, pasi që propozimi për përmbaues është ushtruar conform procedurave ligjore në përputhje me nenin 21,29,37,38,40 të LPK-së përfshirë edhe nenin 341 ku kreditore nga përmbauesi privat ka kërkuar përmbauesin në bazë të dokumentit të besueshëm përkatësisht ekstraktin nga librat afaristë.

Debitori me pagesa të kohë paskohshme ka bërë ndërprerjen e arashkrimit në kuptim të nenit 368 të LMD-së e që pagesa e kësteve në emër të borxhit do të thotë pranimit I borxhit në tërësi sipas dispozitës së nenit 368 par1 dhe 2 të LMD-së. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme parashihet se pagesat eventuale që janë bërë gjatë periudhës së propozimit nuk e ndërprejnë rrjedhën e afatit të parashkrimit po që se ato nuk I referohen ndonjë pagese të ndonjë fature fikse për muaj të caktuar andaj shihet qartë në transaksionin e konsumatorit DMI-26563se debitori me datën 07.03.2014 ka bërë pagesë në shumë prej 11.53 euro të faturës dhe datën 04.03.2014 e cila ishte në vlerë fikse 11.53 euro prandaj ky moment ka shkaktuar ndërprerjen e parashkrimit conform nenit 368 të LMS-së sepse debitori ka pohuar saktë detyrimin si dhe në mënyë konkrete dhe të qartë ka përcaktuar lartësinë e detyrimit që i ka kreditorit, në fjalën përfundimtare kërkoi nga Gjykata që prapësimin e debitorit ta refuzojë në tërësi sit ë pabazuar ndërsa urdhërin përmbartimor të lejë në fuqi ashtu që të detyrohet debitori të paguajë shumën prej 1.362.05 euro.

Debitori në seancë deklaroi se: fillimisht I sqaroj gjykatës se unë nuk jam personi në emër të cilit është regjistruar rryma elektrike pasi që është fakt se A.D.nga fshati Koshtovë, ka qenë gjyshi im kaë qenë dy shtëpi me të njëjtën orë, shtëpia e agjës dhe e babait tim , aty prej vitit2010 nuk ka jetuar askush dhe e njehta është shfrytëzuar për pushime. Në vitin 2019 është ndarë pasuria familjare dhe mua më ka takuar shtëpia e babës në vitin 2019 ka ardhur ekpia e KEK dhe e ka verifikuar se shtëpia është e pabanueshme dhe gjysmë e pamobiluar prej atoj momneti nuk kam lënë asnjë faturë pa paguar specifikoj se qysh prej vitit 2013 e deri në vitin 2019 unë nuk kam jetuar në atë shtëpidhe asnjë faturë e rrymës nuk ka qenë në përgjegjësinë time ndërsa lidhur me fatuën 11.53 euro unë e kam paguar perosnalisht sepse vetëm për atë muaj që është paguar fatura në mars të vitit 2014 e kam shfrytëzuar shtëpinë, ndërs alidhur me borxhin e cekur në propozim mbes në tërësi pranë pranë prapësimit të bërë nuk e di me cfarë të drejte më apo baze ligjore më ngarkohet mua borxhi i gjyshit tim kur I njejt i ka 10 nipa.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor ka adminitrsuar këto prova: Kartelën e konsumatorit DMI-..... në emër të A.D. e datës 18.04.2019, 68 faturat e Energjisë Elektrike nga data11.05.2013 deri me datën 01.03.2019.

Gjykata pas dëgjimit të kreditorit dhe debitorit shqyrtoi të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku vlerësoi se prapësimi I debitorit duhet refuzuar si I pa bazuar.

Nga leximi i kartelës së konsumatorit DMI-.....në emër të A.D., e datës 18.04.2019, rezulton se i njejt i në kuptim të dispozitës së nenit 29 par.1 e LPP-së, në të cilin janë përcaktuar llojet e dokumenteve të besueshme, në bazë të të cilave mund të caktohet përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla. Në nënparagrafin 1.2 të këtij neni përcaktohet: “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”. Në anën tjetër, paragrafi 3 i të njëjtës dispozitë përcakton: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.”, ku në rastin

konkret, propozimi për përmbardim është lejuar në bazë të ekstraktit – kartelës së kontabilitetit nën shifrën me DMI-....., e për të cilin dokument Gjykata vlerëson se paraqet dokument të besueshëm në kuptim të nenit 29 par.1 pika.1.2 lidhur me par.3 të LPP-së.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se debitori me datën 07.03.2014 kishte paguar faturën fikse në shumë prej 11.53 euro, ky fakt vërtetohet me shikim në kartelën e konsumatorit me shifër të identifikimit DMI-..... si dhe pohimin e debitorit në seancën e shqyrtimit publik i cili deklaroi se “...faturën 11.53 euro unë e kam paguar personalisht sepse vetëm për atë muaj që është paguar fatura në mars të vitit 2014 e kam shfrytëzuar shtëpinë,”

Po ashtu për gjykatën nuk ishte kontestuese se shtëpia në të cilën është regjistruar ora elektrike e që përmban kodin DMI-..... është shtëpia e debitorit Ahmet Doroci, fakt I pohuar nga vet debitori gjatë seancës ku ndër të tjera kishte deklaruar se “...Në vitin 2019 është ndarë pasuria familjare dhe mua më ka takuar shtëpia e babës në vitin 2019 ka ardhur ekipa e KEK dhe e ka verifikuar se shtëpia është e pabanueshme dhe gjysmë e pamobiluar prej atoj momneti nuk kam lënë asnjë faturë pa paguar”.

Gjykata pretendimin e kreditorit se debitori me pagesën e faturës në shumën fikse prej 11.53 euro ka shkaktuar ndërprerjen e parashkrimit e vlerësoi si të bazuar në mbështetje të nenit 368 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve në të cilën është përcaktuar se “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e kështit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) në nenin 373 par.1 ka përcaktuar se “Pas ndërprerjes parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim” ndërsa në par.2 të të njejtit nen është përcaktuar rasti kur debitori e ndërpre në parashkrimin me pranim (pagesën e faturës,) si në vijim “Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi), Sipas kartelës së konsumatorit DMI-....., rezulton se debitori me datën 07.03.2014 ka paguar shumën prej 11.53 euro duke shkaktuar kështu ndërprerjen e parashkrimit të borxhit të krijuar deri me datën 07.03.2014.

Sipas dispozitës së nenit 373 par.2 të LMD-së parashkrimi i ndërprerë me pagesën e faturës në shumë prej 11.53 euro ka filluar të rrjedhë prej fillimit nga data e pranimit e që është është data 07.03.2014 pagesa e shumës prej 11.53 euro.

Me pagesën e faturës në shumë prej 11.53 euro është ndërprerë parashkrimi për faturat si në vijim: 05130DMI-26563 në shumë prej 23.92 euro, 06130DMI-26563 në shumë prej 13.93, për faturën 07130DMI-26563 në shumë prej 7.75 euro, për faturën 08130DMI-26563 në shumë prej 36.06 euro, për faturën 09130DMI-26563 në shumë prej 2.63 euro, për faturën 10130DMI-26563 në shumë prej 33.14 euro, për faturën 11130DMI-26563 në shumë prej 13.90, për faturën 12130DMI-26563 në shumë prej 10.70, për faturën 01140DMI-26563 në shumë prej 5.67 euro, për faturën 0214DMI-26563 në shumë prej 11.53 euro, në shumë totale prej 159.23 euro.

Parashkrimi për borxhin nga periudha kohore nga data 04.06.2013 deri më datën 07.03.2014, në shumë totale prej 159.23 euro ka filluar të rrjedhë nga data 07.03.2014 konform dispozitës së nenit 373par2 të LMD-së.

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) në nenin 373 par.6 ka përcaktuar se “Parashkrimi që fillon të rrjedhë përsëri pas ndërprerjes, mbaron kur të ketë kaluar aq kohë sa është caktuar me ligj për parashkrimin që është ndërprerë”, në këtë lëndë përmbarimore kërkohet borxhi në emër të energjisë elektrike e sipas dispozitës së nenit 360 të LMD-së është përcaktuar Afati njëvjeçar i parashkrimit 1. *Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake.*

Kërkesa për kompensimin e borxhit për shpenzimin e energjisë elektrike në shumë prej 159.23euro për periudhën kohore 04.06.2013 deri më 07.03.2014 është parashkruar me datën 07.03.2015 një vit pas ndërprerjes së parashkrimit me pagimin e faturës në shumë prej 11.53 euro me datën 07.03.2014.

Gjykata thekson se në këtë lëndë përmbarimore për borxhin e energjisë elektrike për periudhën kohore nga data 04.06.213 deri më datën 07.03.2014, në shumë prej 159.23 euro afati i parashkrimit është llogaritur nga data e pranimit të borxhit datë 07.03.2014 me të cilën është bërë pagesa e faturës në shumë prej 11.53 euro, sepse për këtë pjesë të borxhit debitori ka ndërprerë afatin e parashkrimit dhe në rastin kur parashkrimi ndërpritet me pranim të borxhit, parashkrimi fillon të rrjedhë rishtazi nga data kur është pranuar borxhi pra aplikohet dispozita e nenit 373 par 2 të LMD-se e cila përjashton zbatimin e dispozitës së nenit 360 par.2 i LMD-së i cili përcakton se “Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë” kjo dispozitë gjen zbatim në rastet kur parashkrimi nuk është ndërprerë.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës në kuptim të dispozitës së nenit 341 par.3 të LMD-së dhe erdhi në përfundim se në raport me borxhin për periudhën kohore nga data 04.06.2013 deri me datën 10.12.2017 në shumë prej 1,020.53 euro kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës në kuptim të dispozitës nga neni 360 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve 04/L-077, andaj gjykata gjeti si të bazuar pretendimin e debitorit në lidhje me parashkrimin e kërkesës, për periudhën e lartcekur.

Gjykata vlerëson se, sa i përket periudhës kohore nga data 09.01.2018 e deri me datë 09.03.2019 nuk ka ardhur në shprehje parashkrimi i kërkesës së kreditorit, për faktin se nuk ka kaluar periudha kohore e paraparë në nenin 360 par.1 nënpar.1 të LMD i cili parasheh se: “kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti janë: “kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake dhe par.2 “Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”.

Gjykata vlerëson se borxhi për shpenzimin e energjisë elektrike për periudhën kohore nga data 09.01.2018 e deri me datën 09.03.2019 përfshin faturat si në vijim: faturën 12170DMI26563 në shumë prej 55.56 euro, faturën 01180DMI26563 në shumë prej 1.88 euro, faturën 02180DMI26563 në shumë prej 1.88 euro, faturën 03180DMI26563 në shumë prej 55.56 euro, faturën 04180DMI26563 në shumë prej 57.56 euro, faturën 05180DMI26563 në shumë prej 23.25 euro, faturën 06180DMI26563 në shumë prej 22.45 euro, faturën 07180DMI26563 në shumë prej 21.24 euro, faturën 09180DMI26563 në shumë prej 11.53 euro, faturën 10180DMI26563 në shumë prej 14.06 euro, faturën 11180DMI26563 në shumë prej 15.44 euro, faturën 12180DMI26563 në shumë prej 16.24 euro, faturën 011900DMI26563 në shumë prej 15.84 euro, faturën 02190DMI26563 në shumë prej 12.37 euro, faturën 021999002DMI26563 në shumë prej 1.61 euro, në shumë prej 396.46 euro.

Borxhi i kërkuar nga kreditori për periudhën e lartcekur nuk është parashkuar, për faktin se kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbarim të datës 18.04.2019, e ka ndërprerë parashkrimin e borxhit për periudhën nga data 09.01.2018 e deri me datën 09.03.2019 kjo për shkak se parashkrimi i borxhit të vitit 2018 ka filluar të rrjedhë në fund të këtij viti, pra me 31.12.2018 dhe i njëjti do të parashkruhej me 31.12.2019, ndërsa borxhi i vitit 2019, do të parashkruhej me 31.12.2020, kurse kreditori paraqitjen e propozimit për përmbarim e ka bërë brenda afatit ligjor 1 vjeçar të paraparë me nenin 360 par.1 të LMD-së.

Paraqitja e propozimit ka bërë ndërprerjen e parashkrimit në kuptim të nenit 369 par.1 të LMDsë që përcakton se: “Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”. Andaj pretendimi i debitorit për parashkrimin e borxhit të kërkuar nga kreditori është i pabazuar.

Bazuar në këto fakte, Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, në pajtim me nenin 73 par.2 dhe 3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin lidhur me pjesën e kërkesës e cila është parashkuar, në shumën prej 1,020.53 euro€, ndërsa e ka refuzuar prapësimin pjesërisht për pjesën e mbetur të borxhit, në shumën prej 396.46€.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e obligoi palën debitore që në rast të parashkrimit të ankesës kundër këtij aktvendimi, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 396.46 €, duke u mbështetur në dispozitën nga neni 78 par.2 të LPP-së, ndërsa në pikën IV të dispozitivit e paralajmëroi të njëjtin se në rast të dështimit të pagesës së shumës së përcaktuar nga Gjykata brenda afatit të paraparë, ankesa do të konsiderohet se nuk është paraqitur fare, në kuptim të nenit 78 par.4 të LPP-së.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të dispozitës nga neni 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
PPP.nr.1058/21, 2021:223122

G j y q t a r j a

Erolinda Uka Sadiku

Udhëzim mbi mjetin juridik: Ndaj këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë, përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.